Hyrje: Ndikimi i historikut të prindërve në sport mbi pjesëmarrjen e fëmijëve në sporte dhe aktivitete fizike ka qenë një temë interesante që ka nxitur kërkimin shkencor. Studimi synon të hulumtojë lidhjen potenciale mes përfshirjes së prindërve në sporte në të shkuarën ose aktualisht dhe pjesëmarrjes së fëmijëve në sporte. Ky abstrakt evidenton ndikimin e historikut të prindërve në sporte mbi angazhimin e fëmijëve në këtë fushë. Metodat: Një total prej 249 fëmijësh nga 8 shkolla të ciklit të mesëm të ulët, të zgjedhura rastësisht nga qyteti i Lezhës morën pjesë në këtë studim. Numri total i djemve ishte 138 dhe numri total i vajzave ishte 111. Të gjithë fëmijët frekuentonin klasën e gjashtë në kohën kur plotësuan pyetësonin. Mësuesi i edukimit fizik, administroi pyetësonin në klasë duke pyetur për numrin e nxënësve që merrnin pjesë në aktivitete sportive, dhe sa prej nxënësve që merrnin pjesë në sporte kishin prindër (njërin ose të dy) që merrnin pjesë në sporte, dhe sa prej tyre nuk kishin asnjërin nga prindërit e përfshirë në sporte. Rezultatet: Rezultati i pyetësorit tregoi se numri i djemve në studim (N = 138) ishte më i lartë se numri i vajzave (N = 111), dhe se ka më shumë djem (N = 59) që marrin pjesë në aktivitete sportive se sa vajza (N = 30). Nga fëmijët që morën pjesë në sporte, 8 prej tyre raportuan se kishin njërin prind që kishte marrë pjesë në sporte, por askush prej tyre nuk raportoi për të dy prindërit të përfshirë. Ndër fëmijët që nuk angazhohenin me aktivitete sportive, vetëm 3 prej tyre raportuan se kishin njërin prind të përfshirë në sporte, por askush prej tyre nuk raportoi që të dy prindërit ishin të përfshirë. Përfundim: Në përfundim, mund të konstatojmë se egziston një korrelacion mes numrit të fëmijëve që merrnin pjesë në sporte dhe numrit të prindërve që kishin një histori të përfshirjes në sporte. Nxënësit që merrnin pjesë në sporte raportuan një numër më të lartë të njërës prind të përfshirë në sporte në të kaluarën e tyre, në krahasim me fëmijët që nuk angazhoheshin me sporte. Sipas rezultateve të këtij studimi, mund të konkludojmë se përfshirja e prindërve në sport mund të luajë një rol në qëndrimin e fëmijëve ndaj sportit, por mund të ketë faktorë të tjerë vendimtarë që kontribuojnë fuqishëm në sjelljet e fëmijëve ndaj sportit, të cilët duhet të hulumtohen më thellë.

Fjalët kyçe: sport, ndikim, pjesëmarrje e prindërve, fëmijë,



The difference in the hand strength of handball players according to the players' positions

Jeton Havolli^{1,2}, Musa Selimi^{2*}

¹*Universum International College/*

²*Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit*

Abstract

Handball is characterized by fast movements, jumps, shots at the goal and contact with the opponent. Strength is one of the skills that enables all these parameters of the handball game. The purpose of this paper was to test the strength of the hands, the measurement of the isometric strength of the hand was done using the electronic dynamometer, where the subject manually squeezes the movable part of the dynamometer for 5 seconds with maximum force. The test was performed with both hands. A total of 93 players of the Kosovo Super League took part in the work. The results were processed with the Anova and Kruskal Wallis Test methods. Pivots achieved the highest level of strength on average (61.66kg) with the right hand. Significant differences have been achieved in relation to players ($p < 0.034$) and goalkeepers ($p < 0.001$). Also, in the left hand, the pivots have shown higher strength (55.38 kg), while the differences between the groups are at a lower level, except for goalkeepers, the difference is at the level ($p < 0.001$), maybe this can be explained that the pivots and the bekas have resulted with better morphological parameters, however, the force has been on their side.

The game of handball is also characterized by the frequent changes of the players' positions on the field, the proportional development of hand strength would contribute to the speed of the game and the efficiency in performing the tasks of the players, either in defense or attack.

Key words: Handball, strength, differences



**UNIVERSITY OF PRISTINA “HASAN PRISHTINA”
FACULTY OF PHYSICAL EDUCATION AND SPORT**
**The 4th Scientific International Conference on Physical Education, Sports and
Health (ICPESH)**
17-18 November 2023, Prishtina, Kosovo

Dallimi në forcën e duarve te hendbollistët sipas pozitive të lojtëarve në fushë

Jeton Havolli^{1,2}, Musa Selimi^{2*}

¹*Universum International College/*

²*Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit*

Abstrakt

Hendbolli karakterizohet më lëvizje të shpejta, kërcime, gjuajtje në portë dhe kontakte me kundërshtarin. Forca është një prej aftësive që i mundëson të gjitha këta parametra të lojës së hendbollit. Qëllimi në këtë punim ka qenë të testohet forca e duarve, matja e forcës izometrike të dorës është bërë duke përdorur dinamometrën elektronik, ku subjekti shtrëngon me dorë pjesën e lëvizshme të dinamometrit për 5 sekonda me forcë maksimale. Testi është kryer me dy duart.

Në punimi gjithsej kanë marr pjesë 93 lojtarë të super ligës së Kosovës. Rezultatet janë përpunuar me metodën Anova dhe Kruskal Wallis Test. Pivotët kanë arritur nivelin më të lartë të forcës me mesatare (61.66kg) me dorën e djathtë. Dallimet signifikante janë arritur në raport me lojtarët alat ($p < 0.034$) dhe me portjer ($p < 0.001$). Gjithashtu edhe te dora e majtë pivotët kanë treguar forcë më të lartë (55.38 kg) ndërsa dallimet mes grupeve janë në nivel më të ultë, për veç me portjera që dallimi është në nivel ($p < 0.001$), ndoshta kjo mund të shpjegohet që pivotët dhe bekat kanë rezultuar me parametra më të mirë morfologjik gjithsesi edhe forca ka qenë në anën e tyre.

Loja e hendbollit karakterizohet gjithashtu edhe me ndërrimet e shpeshta të pozitive të lojtarëve në fushë, zhvillimi proporcional i forcës së duarve do ti kontribuonte shpejtësisë së lojës dhe efikasiteti në kryerjen e detyrave të lojtarëve qoftë ato në mbrojtje ose në sulm.

Fjalët kyçe: Hendboll, forca, dallimet



The importance of measuring functional parameters in persons who attend the gym in Albania

Klotilda Vrenjo ^{1*} Keida Ushtelenca ¹ Ornella Marko¹ Xhovan Zefi¹

¹*Sports University of Tirana, Str. Muhamet Gjollësja, Tirana, Albania*

**kvrenjo@ust.edu.al; klotildavrenjo@yahoo.com*

Abstract

Introduction

Physical activity exercised in gyms is important and advisable if it is done appropriately. Given the fact that in the recent years the gyms and fitness centers are massively attended, the purpose of this study is to identify the way gyms operate in our country as well as to raise the awareness of the population and gym instructors on the importance of routine measurement of health functional parameters. Methodology: Through a survey of our randomly selected targeted population, we aim to evaluate the importance of the health information form/record, medical examination prior and during working out at the gym. This survey was held during the period of January-April 2022, and the surveyed population is 100 people attending the gym, of which 49 males (49%) and 51 females (51%). Measurements were performed with standardized devices such as weight scales, meter, pulse oximeter, mercury blood pressure monitor. Results: The average age of the study population is 25.31. The average value of total BMI was 25.15. 18% of them are smokers and 27% consume alcohol. 0% of these gym-goers state that they have previously performed medical examinations and 0% of them have previously consulted with a doctor. 15% have suffered an injury while working out in the gym. At rest, 9% have DBP over 90 mmHg and 2% have SBP over 140mmHg, so they can be called hypertensive. Conclusions: The information obtained from this study shows the necessity of raising awareness about the importance of periodic measurement of functional parameters among people who attend the gym in Albania. The government needs to impose strict controls and make it mandatory for the gyms and fitness centers to provide and keep health records for each individual attending.

Key words: Physical activity, gym, health record, functional parameters



Evidentimi dhe rëndësia e matjes të parametrave funksionale tek personat që frekuentojnë palestrën në Shqipëri

Klotilda Vrenjo ^{1*} Keida Ushtelena ¹ Ornela Marko ¹ Xhovan Zefi ¹

¹Universiteti i Sporteve të Tiranës, Rr.Muhamet Gjollësja,Tiranë, Shqipëri
kvrenjo@ust.edu.al; klotildavrenjo@yahoo.com

Abstract

Hyrje: Aktiviteti fizik i ushtruar në palestra është i rëndësishëm dhe i këshillueshëm sigurisht nëse kryhet në mënyrë korrekte. Meqënëse vitet e fundit ka një frekuentim në masë, qëllimi i këtij studimi është që të evidentojë mënyrën e funksionimit të palestrave në vendin tonë si dhe ndërgjegjësimin e popullatës dhe instruktorëve të palestrave për rëndësinë e matjes rutinë të parametrave funksionale. Metodologjia: Nëpërmjet anketimit të popullatës target të përfshirë në studim, në mënyrë të rastësishme kërkojmë të vlerësojmë rëndësinë që i kushtohet plotësisht të kartelës, egzaminimit para fillimit dhe gjatë ushtrimit në palestër. Periudha e anketimit Janar- Prill 2022, 100 personat që frekuentojnë palestrën 49M (49%) dhe 51F (51%). Matjet janë kryer me aparate të standartizuara si peshore, metër, pulsioksimetër, aparat tensioni me zhivë. Rezultatet: Moshë mesatare e kampionit është 25.31. Vlera mesatare e BMI-s totale rezultoi 25.15. 18% e frekuentuesve konsumojnë duhan dhe 27% konsumojnë alkool. 0 % e personave që frekuentojnë palestrën të kenë kryer më parë egzaminime mjekësore dhe 0 % të jenë konsultuar më parë me mjekun. 15% kanë pësuar dëmtim gjatë kohës që ushtrohen në palestër. Në qetësi, 9% e kanë TAD mbi 90 dhe 2% kanë TAS mbi 140, pra mund të quhen hipertensive. Konkluzione: Informacionin i marrë nga ky studim tregon domosdoshmërinë e ndërgjegjësisht mbi rëndësinë e matjes periodike të parametrave funksionale tek personat që frekuentojnë palestrën në Shqipëri. Kontrollin e rreptë nga ana e shtetit për pajisjen e detyrueshme të kartelës mjekësore për çdo individ.

Fjalë kyçe: Aktiviteti fizik, palestra, kartela mjekësore, parametra funksionale



Relative Age Effects in The Selection of Representative Athletes of Kosovo National Team in Handball, Football, Basketball, Volleyball - Post Puberty Age

Labinot Haxhnikaj^{1*}, Florian Miftari²

¹*Faculty of Physical Education and Sport, University of Prishtina “Hasan Pristina”, Prishtinë, Republic of Kosovo, St. “Eqrem Qabej”, p.n. 10 000 Prishtinë*

^{*} *Corresponding author e-mail (florian.miftari@uni-pr.edu)*

Abstract

Taking into account the role that the selection of athletes has in the success of clubs as well as in the sports life of young people, this research aims to highlight the impact of the Relative Age Effects (RAE) in the selection of athletes for representative teams of Kosovo in collective sports and the difference between the respective groups. The study was designed as an observational cross-sectional study. The total sample of persons in this research was n=237 (118 male and 119 female) athletes of the Kosovo National Team of team sports. The athletes were divided into 4 main groups: Q1 (January-March), Q2 (April-June), Q3 (July-September) and Q4 (October-December) with a special emphasis on the Q1 and Q4 group (for all sports the birth dates of the age post-puberty were collected). The analysis of the data clearly indicates that young athletes born in Q1 and Q2 were significantly more selected for representative teams compared to those in the other two groups. The results demonstrate a significant relative age effect on athlete selection based on gender for the Kosovo National Team. Specifically, athletes from Q1 and Q2 were favored. Based on these findings, it is strongly recommended that the respective federations, sports trainers, and relevant sports authorities take proactive measures to prevent the “discrimination” experienced by young athletes.

Key words: team sports, dynamic of relative age, selection, quartile, success.



Efektet relative të moshës në përzgjedhjen e sportistëve përfaqësues të Kombëtares së Kosovës në Hendboll, Futboll, Basketboll, Volejboll - Moshë e paspubërtetit

Labinot Haxhnikaj^{1*}, Florian Miftari²

¹Fakulteti Edukimit Fizik dhe Sportit, Universiteti i Prishtinës "Hasan Pristina", Prishtinë,

^{*}Corresponding author e-mail (florian.miftari@uni-pr.edu)

Abstrakt

Duke marrë parasysh rolin që ka përzgjedhja e sportistëve në suksesin e klubeve si dhe në jetën sportive të të rinjve, ky hulumtim synon të nxjerrë në pah ndikimin e Efekteve të Moshave Relative (RAE) në përzgjedhjen e sportistëve për ekipet përfaqësuese të Kosovës në sportet kolektive si dhe dallimin ndërmjet grupeve përkatëse. Studimi u hartua si një studim ndër-seksional vëzhgues. Mostra e totale e personave në këtë hulumtim ishte $n=237$ (118 meshkuj dhe 119 femra) sportistë të Kombëtares së Kosovës për sportet ekipore. Sportistët u ndanë në 4 grupe kryesore: Q1 (janar-mars), Q2 (prill-qershor), Q3 (korrik-shtator) dhe Q4 (tetor-dhjetor) me theks të veçantë në grupin Q1 dhe Q4 (për të gjitha sportet janë mbledhur datat e lindjes së moshës pas pubërtetit). Analiza e të dhënave tregon qartë se sportistët e rinj të lindur në tremujorin e parë dhe në tremujorin e dytë u përzgjedhën dukshëm më shumë për ekipet përfaqësuese në krahasim me ata në dy grupet e tjera. Rezultatet demonstrojnë një efekt të rëndësishëm relativ të moshës në përzgjedhjen e sportistëve bazuar në gjini për Kombëtaren e Kosovës. Konkretisht, u favorizuan atletët nga Q1 dhe Q2. Bazuar në këto gjetje, rekomandohet fuqimisht që federatat përkatëse, trajnerët sportivë dhe autoritetet përkatëse sportive të marrin masa proaktive për të parandaluar "diskriminimin" e përjetuar nga sportistët e rinj.

Fjalët kyçe: sportet ekipore, dinamika e moshës relative, përzgjedhja, kuartil, sukses.



The relationship between the accuracy of passing the ball and its efficiency in the game of volleyball

Laureta Abazi¹, Shpresa Memishi¹, Hamza Veseli¹

¹University of Tetova, Faculty of Physical Education, Tetovo, Republic of North Macedonia

laureta.abazi@unite.edu.mk

Abstract

In this research 100 volleyball players have participated, divided into two subsamples, 50 competitive volleyball players from the first league and 50 volleyball players from the second league.

The predictor variables were: passing with fingers in front of the head from zone III to position IV with passing the ball from zone VI, from the same side of the field; pass with the fingers behind the head from zone III to position II by passing the ball from zone VI, from the same side of the field; the situational-motor skills were evaluated, while the corrective skills were: corrected passes, safe pass, ideal passes and was evaluated the efficiency of the game.

The obtained results show that the system of situational-motor skills has a significant statistical influence on the variables of the ideal passing of the ball in the volleyball players of the first league.

With the analysis of individual regressive coefficients among volleyball players of the first league, the significant correlation with the coefficients, the criteria have variables: passing the ball to the horizontal target with fingers behind the head from zone III, in position II, with passing the ball from zone VI, from the same side of the field.

Key words: Volleyball Player/Precision/Pass



Relacioni ndërmjet precizitetit të pasimit të topit si dhe efikasiteti i tij në lojën e volejbollit

Laureta Abazi¹, Shpresa Memish¹, Hamza Veseli¹

¹Universiteti i Tetovës, Fakulteti i kulturës Fizike, Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut

* Corresponding author laureta.abazi@unite.edu.mk

Abstrakt

Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 100 volejbollistë, të ndarë në dy submostra, 50 volejbollistë garues të ligës së parë dhe 50 volejbollistë nga liga e dytë.

Variablat prediktorë ishin : pasimi me gishta para kokës nga zona e III në pozicionin IV me përcjelljen e topit nga zona VI, nga ana e njejtë e fushës; pasim me gishtat pas koke nga zona e III në pozicionin II me përcjelljen e topit nga zona VI, nga ana e njejtë e fushës; u vlerësuan aftësitë situacio-motorike, ndërsa aftësitë korigjuese ishin: pasimet e korigjuara, pasim i sigurtë, pasime ideale dhe kanë vlerësuar efikasitetin e lojës.

Rezultatet e fituara tregojnë se sistemi i aftësive situacio-motorike ka ndikim signifikant statistikor në variablat pasimin ideal të topit tek volejbollistët e ligës së parë.

Me analizën e koeficienteve individuale regresive tek volejbollistët e ligës së parë lidhshmëria signifikant me koeficientet kriteret kanë variabla : pasimi i topit në cakun horizontal me gishta pas koke nga zona III, në pozitën II, me përcjelljen e topit nga zona e VI, nga ana e njejtë e fushës.

Fjalët kyçe: volejbollist, precizitet, pasim



**UNIVERSITY OF PRISTINA “HASAN PRISHTINA”
FACULTY OF PHYSICAL EDUCATION AND SPORT**
**The 4th Scientific International Conference on Physical Education, Sports and
Health (ICPESH)**
17-18 November 2023, Prishtina, Kosovo

The impact of physical activity on the well-being of girls and women

Bardha Uka¹, Sumeja Osmani¹

NGO DemSport Democracy through sport, Dardani, Prishtina, Kosovo

osmani.sumeja99@gmail.com

Abstract

Aim: Physical activity is an important factor that affects the public health of a country as well as the well-being of its citizens. Different countries of the world have developed specific policies and programs that focus on the increase of physical activity of the citizens. However, Kosovo so far does not have any analysis or measurement of the physical activity of its citizens to better understand their activity or inactivity, which stems from the lack of a cross-sectorial strategy that would focus on building programs and infrastructure for physical activity for all citizens. Therefore, through this research we have analyzed the public spaces that are available in the municipalities of Ferizaj, Graçanica, Prishtina and Prizren, as well as the (lack of) physical activity of women aged 18-70, in these municipalities. Method: The subjects of the research are the experiences of girls and women aged 18-70 years old, in regard to their physical activities. In addition, the public programs and policies of the municipal level have been analyzed, focusing on factors that have direct impact on the inactivity of girls and women. The methodology consisted of desk research where the international practices and the country legislation have been analyzed and the statistical research which included interviewing 300 women from 7 different communities in 4 municipalities. Results: A) Until the publication of this research report, Kosovo has not developed an analysis or measurement of the physical activity of its citizens to better understand their activity or inactivity; B) the municipal level lacks strategies for providing programs, infrastructure and opportunities for physical activity for the citizens of their municipalities; C) Girls and women do not have enough information, knowledge and awareness about the importance of physical activity and the impact it has on physical and mental health; D) Women do not fulfill the physical activity standards according to the WHO; E) Girls and women are more burdened than men with housework and child care, therefore they do not have enough time and space for physical activity for themselves; F) The departments within the municipalities do not prioritize the physical activity of women or the promotion of the positive impact that physical activity has on general well-being;

Key words: physical activity, women, well-being, public health.



Ndikimi i aktivitetit fizik i vajzave dhe grave, në mirëqenien e tyre

Bardha Uka¹, Sumeja Osmani¹

NGO DemSport Democracy through sport, Dardani, Prishtinë, Kosovë
osmani.sumeja99@gmail.com

Abstrakt

Objektivi: Aktiviteti fizik është një faktor i rëndësishëm që ndikon në shëndetin publik të një vendi, si dhe në mirëqenien e qytetarëve të tij. Vendet e ndryshme të botës kanë zhvilluar politika dhe programe specifike që fokusohen në rritjen e aktivitetit fizik të qytetarëve. Megjithatë, Kosova deri më tani nuk ka asnjë analizë ose matje të aktivitetit fizik të qytetarëve të saj për të kuptuar më mirë aktivitetin ose pasivitetin e tyre, gjë që vjen si pasojë e mungesës së një strategjie kryqëzore që do të përqëndrohej në ndërtimin e programeve dhe infrastrukturës për aktivitetin fizik për të gjithë qytetarët. Prandaj, nëpërmjet këtij hulumtimi kemi analizuar hapësirat publike që janë të disponueshme në komunat e Ferizajit, Graçanicës, Prishtinës dhe Prizrenit, si dhe (mungesën) e aktivitetit fizik të grave në moshë 18-70 vjeç, në këto komuna. Metodologjia: Subjektet e hulumtimit janë përvojat e vajzave dhe grave në moshë 18-70 vjeç, në lidhje me aktivitetet e tyre fizike. Po ashtu, janë analizuar programet dhe politikat publike në nivel komunal, me fokus në faktorët që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në pasivitetin e vajzave dhe grave. Metodologjia përfshinte hulumtimin në tavolinë, ku janë analizuar praktikat ndërkombëtare dhe legjislativi i vendit, si dhe hulumtimin statistikor që përfshinte intervistimin e 300 grave nga 7 komunitete të ndryshme në 4 komuna. Rezultatet: A) Deri në publikimin e këtij raporti hulumtor, Kosova nuk ka zhvilluar një analizë ose matje të aktivitetit fizik të qytetarëve të saj për të kuptuar më mirë aktivitetin ose pasivitetin e tyre; B) nivelin komunal i mungojnë strategjitë për sigurimin e programeve, infrastrukturës dhe mundësive për aktivitetin fizik për qytetarët e tyre; C) Vajzat dhe gratë nuk kanë mjaft informacion, njohuri dhe ndërgjegjësim në lidhje me rëndësinë e aktivitetit fizik dhe ndikimin që ka në shëndetin fizik dhe mental; D) Gratë nuk plotësojnë standardet e aktivitetit fizik sipas WHO; E) Vajzat dhe gratë janë më të ngarkuara se burrat me punët e shtëpisë dhe kujdesin për fëmijët, prandaj nuk kanë mjaftueshëm kohë dhe hapësira për aktivitet fizik për veten; F) Departamentet brenda komunave nuk e prioritojnë aktivitetin fizik të grave ose promovimin e ndikimit pozitiv që ka aktiviteti fizik në mirëqenien e përgjithshme.

Fjalët kyçe: aktiviteti fizik, gratë, mirëqenia, shëndeti publik.



**Perception of the risk of injuries in alpine skiing in Kosova (comparison
between elite skiers, recreational skiers and individuals with no skiing
experience)**

Tritan Maliqi^{1*}, Bujar Turjaka^{2*} *Corresponding author*

¹NA,

² *University of Prishtina/Faculty of Physical Education and Sport*

Abstract

Alpine skiing is one of the most popular winter sports. Participation in this sport, however, depends, among other things, on individuals' perspectives on the risk of injuries during alpine skiing. For this reason, the purpose of this research is to collect and compare data related to the perception of injury risk in alpine skiing among three different groups in the Republic of Kosova: elite skiers, recreational skiers, and individuals without experience in alpine skiing. This study uses a qualitative research method, using semi-structured interviews as the primary method for data collection. Such an approach allows participants to express their opinions freely and without imposition, thus expanding the possibility of understanding the data collected in the study. The study sample consists of 15 participants, with 5 selected for each group, ensuring adequate representation for each respective group. The results indicate that there are different, similar, and individual perceptions among the participants in the three groups regarding the risk of injuries in alpine skiing. The differences and similarities of the perceptions of study participants on the risk of injuries can be explained by several factors, such as the level of experience, knowledge and exposure to information related to skiing. Understanding these differences and factors helps in developing appropriate strategies for education and awareness raising among individuals regarding the risk of injuries in skiing.

Key words: alpine skiing, injuries, elite skiers, recreational skiers, research, interviews.



**Perceptimi i rrezikshmërisë së lëndimeve në skitarinë alpikë në Kosovë
(krahasim mes skiatorëve elitare, skiatorëve rekreacional dhe individëve pa
eksperiencë në skitari)**

Tritan Maliqi^{1*}, Bujar Turjaka^{2*} *Corresponding author*

¹NA,

¹Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Abstrakt

Skijimi alpik është një ndër sportet më popullore dimërore. Megjithatë, pjesëmarrja në këtë sport varet ndër të tjera edhe nga pikëpamjet e individëve rreth rrezikshmërisë së lëndimeve gjatë skijimit alpik. Për këtë arsye, qëllimi i këtij hulumtimi është mbledhja dhe krahasimi i të dhënave lidhur me perceptimin e rrezikshmërisë së lëndimeve në skitarinë alpikë në mes të tre grupeve të ndryshme në Republikën e Kosovës: skiatorët elitare, skiatorët rekreacional dhe individ pa përvojë në skitarinë alpikë. Në këtë punim është përdorur metoda cilësore e kërkimit duke përdorur intervistat gjysme të strukturuar si metode primare për mbledhjen e të dhënave. Një qasje e tillë, ofron mundësin pjesëmarrësve të japin mendimin e tyre në mënyre të lirë dhe të pa imponuar, si rrjedhojë zgjeron mundësin e të kuptuarit të të dhënave të mbledhura në studim. Mostra e studimit përbehet nga 15 pjesëmarrës, me nga 5 të përzgjedhur për secilin grup, ashtu që është siguruar përfaqësim i denjë për secilin grup përkatës. Rezultatet treguan se ka perceptime të ndryshme, ngjashme dhe individuale në mes të të intervistuarave në tre grupet mbi rrezikshmërinë e lëndimeve në skitarinë alpikë. Këto ndryshime dhe ngjashmëri në perceptimet e rrezikshmërisë së lëndimeve të pjesëmarrësve të këtij studim mund të shpjegohet nga disa faktorë, si niveli i përvojës, njohurive dhe ekspozimi ndaj informacionit lidhur me skijimin. Kuptimi i këtyre dallimeve dhe faktorëve ndihmon në zhvillimin e strategjive të përshtatshme për edukimin dhe ndërgjegjësimin e individëve në lidhje me rrezikshmërinë e lëndimeve në skijim.

Fjalët kyçe: skijimi alpik, lëndime, skiator elitare, skiatorë rekreacional, kërkime, intervista.



Evaluation of health-risky factors in early adult students from Sports
University of Tirana, Albania

Dhurata Bozo

Sports University of Tirana, Institute for Sport Research, Tirana, Albania
Rruga “Muhamet Gjollësia”, 1001, Tirana, Albania

Corresponding author: dhbozo@ust.edu.al

Abstract

Research goal: Health biomarkers in the context of physical activity and sports are being widely studied, investigated and used, especially in the last 10-20 years. The indicators considered in this study are determined by multiple factors such as genetic, biochemical and physiological and influenced by external factors such as exercise, training, cultural, and social ones during early adulthood, many lifelong behaviors that have an impact on health are set in place. Lack of exercise, malnutrition, smoking, alcohol are among the main factors for conditions such as heart disease, obesity, type 2 diabetes and other life-threatening diseases. The goal of this study is to measure, estimate and identify the prevalence of health-related parameters in a sample of highly active/sport young adults, presuming *a priori* the absence of such problems in this group. A comparative analysis with a control classmate group was performed as well.

Methodology: A group of 127, 18-20 years old students, 68 females and 59 males from Sports University of Tirana underwent this study. The control group consisted of 134 students from the Rehabilitation Faculty of the same university. A series of anthropometric, cardiac and hematological indicators were estimated in both study and control groups.

Results: The results of key health-related parameters such as body mass index, body fat mass and visceral fat show average values of 23.4, 28.5 and 3.9 % respectively. Surprisingly, only 77.6% of the subjects display values within the normal ranges of the respective age and gender. Interestingly females show normal values of visceral fat percentage (3.6%), despite the unexpected high values of Body Fat Mass of 33.5%. Normal average values instead were found for cardio-respiratory data as Heart Rate (77.6 bpm), pO₂ (97%), blood pressure (117/75mmHg) and glycaemia (102mmol/dl). Compared to non-active classmates, the differences were not significant in some physiological parameters and for glycaemia.

Summary: Even though they are preliminary and partial results of a wider and multi-factorial study, they highlight the importance of evaluating health-related indicators and risky behaviors even in physically active or sport individuals.

Key words: health indicators, sports, sports university, Albania.



Vlerësimi i treguesve shëndetësorë në studentët e Universitetit të Sporteve të Tiranës

Dhurata Bozo

*Universiteti i Sporteve të Tirans, Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit
Rruga "Muhamet Gjollesha", 1001, Tiranë, Shqipëri
Personi i kontaktit: dhbozo@ust.edu.al*

Abstrakt

Qëllimi i studimit: Biomarkatorët e lidhur me shëndetin në kuadër të aktivitetit fizik dhe sportit janë studjuar dhe përdorur gjerësisht vecanërisht në 10-20 vitet e fundit. Indikatorët e marë në shqyrtim në këtë studim varen e përcaktohen nga një sërë faktorësh si ata gjenetikë, biokimikë dhe fiziologjikë dhe në të njëjtën kohë ndikohen nga faktorë të jashtëm si të ushtruarit, stërvitja, faktorë kulturorë dhe socialë, të cilët duke filluar nga rinia e hershme, përmes sjelljeve afatgjata të papërshtatshme, kanë një impakt të rëndësishëm në shëndetin e subjekteve që ushtrohen fizikisht. Mungesa e aktivitetit fizik, kequshqyerja, duhani, përdorimi i alkoolit janë ndër faktorët kryesorë për problematika shëndetësore si sëmundjet kardiake, obeziteti, diabetii llojit 2 dhe patologji të tjera kërcënuese për jetën. Qëllimi i këtij studimi është të matë, vlerësojë, dhe identifikojë prevalencën e parametrave të lidhur me shëndetin në një kampion përfaqësues të studentëve të Universitetit të Sporteve të Tiranës, duke presuar *a priori* mungesën e këtyre problematikave në subjekte fizikisht aktivë. Të dhënat grupit të studimit do të ballafaqohen me ato të një grupi kontrolli, të të njëjtës grupmoshë, përfaqësues të popullatës normale.

Subjektet dhe Metoda: Në këtë studim u përfshinë një grup prej 127 studentësh të grupmoshës 18-20 vjeçare, ndër të cilët 68 meshkuj dhe 59 femra, student të Universitetit të Sporteve të Tiranës (USY). Grupi kontrolli përbëhej nga 34 studentë nga Fakulteti i Rehabilitimit, të cilët nuk i nënshtrohen testit fizik për pranimin në UST. U matën dhe vlerësuar një sërë treguesish antropometrikë, kardio-respiratorë dhe hematologjikë sin në grupi e kontrollit ashtu dhe në atë të studimit.

Rezultatet: Rezultatet e mara në parametrat truporë si indeksi i masës trupore (BMI), ynnrat trupore (BFM) dhe yndyrnat visherale (VF) tregojnë vlera relative 23.4, 28.5 dhe 3.9 përkatësisht. E papritur është fakti që vetëm rreth 77% e subjekteve të grupit të studimit (fizikisht aktivë) kanë vlera Brenda kufijve normal të këtyre parametrave. Vlen gjithashtu të theksohet se të gjitha femrat paraqesin vlera normale të yndyrnave visherale (mesatare 3.6%), edhe pse vlerat mesatare të yndyrnave trupore janë më të larta se norma (33.5%). Ndërkohë u gjetën vlera normale për treguesit kardio-respiratorë si ato të frekuencës kardiake (77.6 bpm), pO₂ (97%), presionit arterial (117/75mmHg) dhe të glicemisë (102mmol/dl). Krahasuar me bashkëmoshtarët "joaktivë", tregon për ndryshime josingjifikative të paktën për parametra si ato fiziologjikë dhe gliceminë.

Përmbledhje: Megjithëse këto janë rezultatet paraprake dhe të pjesshme të një studimi afatgjatë dhe më të gjerë që po kryhet nga grupi i kërkimit, gjithsesi del në pah rëndësia që ka vlerësimi i treguesve si ata të analizuar në këtë studim për të garantuar së pari tregues shëndetësorë normalë vecanërisht për individët që merren me aktivitet fizik e sport, si subjekte më të ekspozuar ndaj zhvillimit të problematikave që vijnë nga tejshtrimi apo keqshtrimi, krahas faktorëve të tjerë të sipërpërmendur.

Fjalët kyçe: indikatorë shëndetësorë, sport, universiteti i sportit, Shqipëria



**UNIVERSITY OF PRISTINA “HASAN PRISHTINA”
FACULTY OF PHYSICAL EDUCATION AND SPORT**
**The 4th Scientific International Conference on Physical Education, Sports and
Health (ICPESH)**
17-18 November 2023, Prishtina, Kosovo

**The impact of body mass index on movement coordination in girls of the IVth
and IXth grades - Prishtina Region**

Endrita Jashanica¹, Ilir Gllareva^{1*}, Gjyke Bajraj¹

¹*Faculty of Physical Education and Sports - University of Pristina "Hasan Prishtina"*

* *Corresponding author e-mail: ilir.gllareva@uni-pr.edu*

Abstract

The main purpose of this research is to verify the status of physical growth and motor development in girls of the VI and IX classes of the Prishtina Region, as well as the influence of the body mass index (BMI) on motor coordination. Anthropometric parameters were tested with measurements in: (height, body mass, arms extended to the sides and parameters of subcutaneous adipose tissue – back, arms, abdomen and cartilage). While the motoric abilities were tested with measurements in: (handgrip of the right and left hand, long jump, walking back ward and front body flexibility). The results show that in the group of VI-th grade girls, a relatively heterogeneous distribution was extracted in the anthropometric parameters, as well as in the movement space. It is worth noting that heterogeneous distribution is also presented in the results of girls of class IX-th in both areas. By means of regression analysis, we found that in both the VI-th and IX-th classes, the body mass index has been shown to be a predictor of motor coordination, the students categorized with normal weight and those with light weight have better results in the tasks of motor coordination in contrast to girls who are categorized as overweight and obese.

Key words: Influence, coordination, body mass index, girls.



Ndikimi i indeksit të masës trupore në koordinim lëvizor tek vajzat e klasave të IV-të dhe IX-të – Regjioni i Prishtinës

Endrita Jashanica¹, Ilir Gllareva^{1*}, Gjyke Bajraj¹

¹Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

* Corresponding author e-mail: ilir.gllareva@uni-pr.edu

Abstrakt

Qëllimi kryesorë këtij hulumtimi është të vërtetohet statusi i rritjes fizike dhe zhvillimit lëvizor tek vajzat e klasave të VI-të dhe IX-të të Regjionit të Prishtinës, si dhe ndikimi i indeksit të masës trupore (IMT) në koordinim lëvizor. Hapsira antropometrike është testuar me matjet në: (lartësia, masa trupore, krahët e shtrirë anash dhe parametrat e indit dhjamorë nënlëkuror – shpinë, krahë, bark dhe kërcir). Ndërsa hapsira lëvizore është testuar me matjet në: (dinamometri e dorës së djathtë dhe e majtë, kërcimi nga vendi në gjatësi, ecje së prapthi dhe fleksibilitet i trupit para). Rezultatet tregojnë se tek grupi i vajzave të klasës së VI-të është ekstrahuar shërndarje relativisht heterogjene në parametrat antropometrik, e po ashtu edhe në hapësirën lëvizore. Vlenë të theksohet se shpërndarje heterogjene është paraqitur edhe tek rezultatet e vajzave të klasës së IX-të në të dyja hapsirat. Me anë të analizës regressive kemi konstatuar se tek të dyja klasat VI-të dhe IX-të Indeksi i masës trupore është treguar parashikues i koordinimit lëvizorë, nxënëset e kategorizuara me peshë normale dhe ata me peshë të lehtë kanë rezultate më të mira në detyrat e koordinimit lëvizorë për dallim prej vajzave të cilat janë kategorizuar me mbipeshë dhe obez.

Fjalët kyqe: Ndikim, koordinim, indeks i masës trupore, vajza.



Quality of life and impulsivity in depression and anxiety in a community sample

Arta Ahmeti^{1*}, Adelina Pronaj²

¹*Spitali Premium Prishtinë*

* *Corresponding author e-mail (artaahmeti_10@hotmail.com)*

Abstract

Introduction: Depression, especially clinical depression, is strongly associated with suicide. Impulsivity is one of the main dimensions of suicide. The aim of this study was to evaluate the structure of impulsivity in clinical depression and its relationship with suicide attempts. Depression and anxiety are psychiatric illnesses that impair quality of life (QoL). Specific purpose: to assess the knowledge, attitude, practice, relevant factors of health professionals and the actions taken in cases of health emergencies and natural disasters.

Methodology: To achieve this goal, the study was developed in the form of a questionnaire, which was self-administered by the participating subjects, doctors and nurses, in the public health care system in the District of Tirana. The study was conducted on over 700 participants. Depression and anxiety is based on a positive score on the Beck Depression Anxiety (BDA) and the Beck Depression Inventory (BDI).

The Barrat Impulsivity Scale (BIS-11) is a 30-item self-report instrument designed to assess the behavioral construct of impulsivity. Statistical Package for the Social Sciences (SPSS) program v.20.0 (SPSS Inc. Chicago, IL, USA) was used for statistical analysis. Socio-demographic variables such as age and gender will be compared between groups through the use of Chi tests.

Conclusions and Recommendations: This study has found that the quality of life in people who have reported depression is a predictor for the appearance of impulsivity. Impulsivity is important to be assessed by clinicians.

Key words: quality of life, depression, anxiety, health professional.



Cilësia e jetës dhe impulsiviteti në depresion dhe ankth në një mostër të komunitetit

Arta Ahmeti^{1*}, Adelina Pronaj²

¹*Spitali Premium Prishtinë*

* *Corresponding author e-mail (artaahmeti_10@hotmail.com)*

Abstrakt

Hyrje: Depresioni, posaqërisht depresioni klinik është i lidhur fuqishëm me suicidin. Impulsiviteti është një nga dimensionet kryesore të suicidit. Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i strukturës së impulsivitetit në depresionin klinik dhe marrëdhëniet e tij me tentimet e suicidit. Depresioni dhe ankthi janë sëmundje psikiatrike që e dëmtojnë cilësinë e jetës (QoL). Qëllimi specifik: është të vlerësojë njohuritë, qëndrimin, praktikën, faktorët përkatës të profesionistëve shëndetësorë dhe veprimet që kryhen në raste të emergjencave shëndetësore dhe fatkeqësive natyrore.

Metodologjia: Për të arritur këtë qëllim studimi u zhvillua në formën e një pyetësoi, i cili u vetë-administrua nga ana e subjekteve pjesëmarrëse, mjekë dhe infermierë, në sistemin publik të kujdesit shëndetësor në Qarkun e Tiranës. Studimi është kryer në mbi 700 pjesëmarrës. Depresioni dhe ankthi është bazuar në rezultatit pozitiv të Ankthit të Beckut për Depresion (BDA) dhe Inventarin e Beckut për Depresion (BDI). Shkalla e Impulsivitetit Barrat (BIS-11) është një instrument vetë-raportues me 30 pika, dizajnuar për vlerësimin e konstruktit të sjelljes së impulsivitetit. Paketa statistikore për shkencat sociale (SPSS) programi v.20.0 (SPSS Inc. Chicago, IL, USA) është përdorur për analiza statistikore. Variablat socio-demografike, siç janë mosha dhe gjinia do të krahasohen midis grupeve, përmes përdorimit të Chi testeve.

Përfundime dhe Rekomandime: Ky studim ka gjetur se kualiteti i jetës në personat të cilët kanë raportuar depresion të jetë një prediktorë për shfaqjen e impulsivitetit. Impulsiviteti ka rëndësi të jetë pjesë e vlerësimit nga klinikistët.

Key words: cilësia e jetës, depresion, ankth, profesionist shëndetësor.



Motivation and knowledge about swimming among students aged 11 to 14 in the municipality of Ferizaj

Lirie Maliqi^{1*}, Ilir Gllareva¹, Hasim Rushiti^{1*}

¹*Faculty of Physical Education and Sports – University of Prishtina “Hasan Prishtina”*

* *Corresponding author e-mail: hasim.rushiti@uni-pr.edu*

Abstract

The purpose of the research was to verify the knowledge about swimming as an activity, the motivation aspect for swimming, as well as potential risks among children aged 11 to 14 in the Municipality of Ferizaj. A sample of 200 children, both girls and boys, were subjected to a questionnaire containing 20 questions about the stated objectives, and the conclusions were as they were expected. The research was oriented with a set of questions related to knowledge, motivation for swimming and water activities, opportunities for water activities, as well as awareness of potential risks in water-related activities. From the interviewed sample, it shows that over 85% of the children have a high or moderate interest in swimming. Results show that urban schools have better results than rural ones (around 80% have insufficient knowledge about swimming in rural areas, while over 60% in urban areas have moderate knowledge). A small percentage of children had knowledge about swimming techniques, also the same results were on answering their preferred technique. When asked about potential water-related risks, children had very insufficient information. As for swimming opportunities, it turns out that the conditions and swimming schools are missing. The analysis of the results, in addition to demographic parameters, frequencies, and percentages, is also presented with descriptive analysis illustrated through graphical representation. From the research results, it is concluded that swimming is a preferred activity, but opportunities for swimming are limited. Children learn to swim ad hoc from their parents, without any formal instructions. There is a significant lack of swimming infrastructure. Even when children are in the water, they play games because they do not know how to swim. As a result of this inability, a most of the children presents a potential risk of drowning in water. Swimming is presented as an interesting sport when the prerequisites for developing it as a sports and recreational activity are not lacking.

Key words: swimming, students, swimming knowledge, motivation, risks.



Motivimi dhe njohuritë për not tek nxënësit e moshës 11 dhe 14 vjeç në komunën e Ferizajt

Lirie Maliqi^{1*}, Ilir Gllareva¹, Hasim Rushiti^{1*}

¹Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

* Autor korrespondent e-mail: hasim.rushiti@uni-pr.edu

Abstrakt

Qëllimi i hulumtimit ishte vërtetimi i njohurive rreth notit si aktivitet, aspekti i motivimit për sportin e notit, si dhe rreziqeve potenciale tek fëmijët e moshave 11 dhe 14 vjeç në Komunën e Ferizajit. Mostra prej 200 fëmijëve, vajza dhe djem, i janë nënshtruar pyetësorit që përmbante 20 pyetje rreth qëllimit të parashtruar dhe që është realizuar duke nxjerrë perfundime të pritura. Hapsira e hulumtuar ishte e orientuar me grup pyetjesh që ndërlidheshin me njohuritë, motivimin për not dhe aktivitete ujore, mundësitë për të zhvilluar aktivitete ujore si dhe njohuritë për rreziqet potenciale në aktivitetet në ujë. Nga mostra e intervistuar rezultoi që mbi 85% e fëmijëve kanë pëlqim për notin shumë ose mesatarisht, rreth njohurisë së notit rezultoi që shkolla nga qyteti ka rezultate më të mira se ajo nga fshati (rreth 80% kanë njohuri të mangët në zonë rurale dhe mbi 60% të zonës urbane kanë njohuri mbimesatare). Përqindje e vogël e fëmijëve kishin pak njohuri për numrin e teknikave të notit, rrjedhimisht edhe nuk kishte shumë përgjigje për teknikën e preferuar. Lidhur me rreziqet potenciale në ujë fëmijët kishin mjaftë pak informata. Lidhur me mundësitë për not rezultoi që mungonin kushtet dhe shkollat e notit. Analiza e rezultateve, përveç parametrevë demografik, frekuencave dhe përqindjeve, është paraqitur edhe me analizë deskriptive të ilustruar përmes paraqitjes grafike. Nga rezultatet e nxjerra nga hulumtimi kemi konstatuar që noti është aktivitet i preferuar por që mungojnë mundësitë për not, pra janë të kufizuara. Fëmijët notin e mësojnë ad’hok nga prindërit, por pa ndonjë mësim formal. Ka mungesë të theksuar të infrastrukturës për not. Edhe kur fëmijët janë në ujë, ata zhvillojnë lojëra ngase nuk dijnë not. Si rrjedhojë e pamundësisë, pjesa dermuese e fëmijëve paraqesin rrezik potencial për mbytje në ujë, dhe se noti praqitet si sport me interes në rast të ofrimit të parakushteve për ta zhvilluar si aktivitet sportiv dhe rekreativ.

Fjalët kyçe: not, nxënës, njohuri për not, motivacion, rreziqe.



Nutritional status and anthropometric characteristics of kindergarten children

Shkodra Mimoza¹, Gjinovci Bahri²

¹*Faculty of Physical Culture and Sports, AAB College, Pristina*

²*Faculty of Physical Education and Sports, University of Pristina, Pristina*
mimoza.shkodra@universitetiaab.com

Abstract

The purpose of the paper: The growth of a child is a reflection of the state of nutrition. In some countries such as Kosovo, which has frequent changes in economic growth and population decline, the nutritional status of children is a reflection of the general well-being of society. Materials and methods: This is a descriptive and comparative paper between the two largest kindergartens in Gjiilan with the selection of goals and samples. The groups of children included in this research are the groups of 3-4, 4-5, 5-6 years old. A total of 124 children from two kindergartens are involved. A standard protocol was used describing the data on the card of each child, young and old. Two serving meals and snacks were monitored for two weeks, which were calculated in grams of macronutrients consumed and their distribution in daily amounts and were compared with the amount recommended for a certain age group according to the "FAO" organization. Notes were kept on the type of food served as well as the amount consumed. Made Children's anthropometric measurements, such as weight and height, from which was calculated the Body Mass Index (BMI). For processing results, basic statistical parameters and T-test analysis were applied to verify the differences. The results: obtained show that the average body mass index is Average = 16.0032, in the children of the "Ardhmeria 2" kindergarten, while the average = 16.17 in the "Dardania" kindergarten. Regarding the changes in the intake of macronutrients while staying in the kindergartens, significant statistical values were obtained in both kindergartens with $p=0.000$, while the difference between the nutrition during the stay in the kindergarten and the daily recommendations is $df=62$ in the kindergarten "Dardania" while $df=59$ in the garden "Ardhmeria 2". These results indicate the lack of sufficient nutrition in kindergarten and that the prevalence of undernutrition is higher than malnutrition and if these macronutrients are not met in the dinner meal, children tend to grow unhealthy.

Key words: Children, macronutrients, BMI, calories, health.



